



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT	MINISTRY OF EDUCATION	MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	SCIENCE & TECHNOLOGY	NAUKU I TEHNOLOGIJU
Kabineti i Ministrit	Office of the Minister	Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

NUMËR: MASHT[I] 49/2004

Data: 23 gusht 2004

**LËNDA: ZBATIMI I PLANIT DHE PROGRAMIT PËR ARSIMIN PROFESIONAL,
PROFILI TEKNIK PËR PAJISJET E ZYRËSPËR KLASËN E DHJETË,
NJËMBËDHJETË DHE DYMBËDHJETË (10, 11, 12)**

Në bazë të nenit 6.1 paragrafi (d) dhe nenit 12.2. (a),(b) lidhur me nenin 4 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm dhe në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degen e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i Planit dhe programit mësimor për shkollat profesionale, klasën e dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë, si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit fillor dhe të mesëm.

Neni 2

Plan-programi

Plani dhe Programi i ri për klasën e dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë, profili **Teknik për pajisjet e zyrës**, i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3

Zbatueshmëria

3.1. Plani dhe Programi për klasën e dhjetë dhe njëmbëdhjetë zbatohet nga viti shkollor 2004/2005, ndërsa për klasën e dymbëdhjetë do të zbatohet në vitin shkollor 2005/2006.

3.2. Me zbatimin e Planit dhe Programit të klasës së njëmbëdhjetë zëvendësohen planet dhe programet e deritashme të klasës së tretë, ndërsa me zbatimin e planit dhe programit të klasës së dymbëdhjetë do të zëvendësohen planet dhe programet e deritashme të klasës së katërt të shkollës së mesme profesionale.

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi me fillimin e vitit shkollor 2004/2005.

Mr. Rexhep Osmani, Ministër